



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më:	06.08 20 25	
Priljeno:		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
05-453/01-4M78		



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale Nr.03/L- 040- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 të datës 4 qershor 2008, Rregullores MF - NR – 04/2017 mbi Kriteret, Standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110-78095 i datës 24.12.2021, Drejtoresha e DKRS-së merr këtë :

VENDIM PËR SHPALLJE TË THIRRJES PUBLIKE KLUBET SPORTIVE

I

Për shpalljen e Thirrjes Publike për mbështetje financiare publike për aktivitete të Organizatave Joqeveritare në fushën e sportit.

II

Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF - NR – 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti I KOMUNËS (DKRS) kodi i programit 85003 SUBVENCIONE në kuadër të DKRS-së.

III

Mjetet e përmendura në nenin II do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

IV

Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II. të këtij vendimi përfshinë:

1. Teksti i thirrjes publike ;
 2. Udhëzimet për aplikantët ;
 3. Formularët e aplikimit ;
 4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve ;
 5. Format për raportimin e zbatimit të projektit
- 2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:**
1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit ;
 2. Forma e buxhetit të programit apo projektit ;
 3. Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta ;
 4. Deklaratat e Partneritetit (nëse është e aplikueshme) ;
 5. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike

6. Deklarata për Aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet).

3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:

1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit ;
2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin ;
3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit ;

V

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare (web faqe).

VI

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

VII

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, aktivitetet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.
2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport .

VIII

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Lipjan, 05.08.2025

Anila Reçica Llugiqi
Drejtoreshë e DKRS-së

